# VENDIM
## Nr. 371, datë 22.6.2021

## PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR TEK AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR, TË PASURISË ME NR. 6/30, ZONA KADASTRALE 8562, KORÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor tek Autoriteti Rrugor Shqiptar, të pasurisë me nr. 6/30, zona kadastrale 8562, me sipërfaqe totale 560 $m^2$, Korçë, sipas planit të rilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, do të përdoret për ushtrimin e veprimtarisë së Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Autoritetit Rrugor Shqiptar sh.a., i ndalohet ta tjetërsojë apo t'ua japë në përdorim të tretëve pasurinë e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit bashkëlidhur vendimit nr. 226, datë 23.4.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës", të ndryshuar, dhe i shtohet listës së inventarit bashkëlidhur vendimit nr. 3, datë 7.1.2005, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit".

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

**PRONARI: D. P. SH. T. RR** | **DATE: 07/ 05/ 2021** | **QELLIMI: REGJISTRIM**

**VENDNDODHJA**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| BASHKIA KORÇË | DVASHK/ZVASHK KORÇË | ZONA KADASTRALE 8562 | NUMRI PASURISE 6/30 | INDEX HARTE KO - H - 11 |

**TE DHENAT E PASURISE**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| LLOJI PASURISE TRUALL | SIP.PASURISE= 560.00m2 | SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= 208.89m2 | NUMRI KATEVE 3 | ADRESA BLV"RILINDASIT" |

X 566945
Y 4500106

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 567042
Y 4500106




X 566945
Y 4500034

**SH 1:500**

X 567042
Y 4500054

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | VERI | | NR. PAS | 1/553, 6/570 | | |
| 2 | JUGE | | NR. PAS | 6/410, 6/408 | | |
| 3 | LINDJE | | NR. PAS | 6/408, 6/524 | | |
| 4 | PERENDIM | | NR. PAS | 1/553 | | |

**REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT**

EMRI: Ing. Esmerald Muçollari

LICENCA: NR. T.1250 DATE: 24/ 07/ 2017

Esmerald Mucollari

Digitally signed by Esmerald Mucollari
Date: 2021.05.10 09:18:07 +02'00'

NENSHKRIMI/VULA

**TEKNOLOGJIA E MATJEVE: S, D**

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

**PERCAKTIMI KUFIRIT: P**

Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

**SHENIME TE VECANTA:**

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale